



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 1110 Prot.

Tiranë, më: 04.02. 2020

Vendimi 05

REFUZIM DEKLARATE MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Mos pajisjen me Deklaratë Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Person juridik: “Gealb Energy” sh.p.k.

Nr. NIPT-i: L76607401A

Adresa e selise: Dibër, Bulqizë, Rruga "Murat Zhaboli", Pallati Nr.17, Shkalla Nr.1, Kati 3

Personi përgjegjës: Genc Mërkuri

Për të zhvilluar projektin “**Ndërtim HEC Guri i Bardhë 1 dhe Guri i Bardhë 2**”

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 9, “Projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”, Pika 1. Procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen: b) projektet, për të cilat vendimi i AKM-së parashikon nevojën e zbatimit të kësaj procedure.

Vendndodhja: fshati Guri Bardhë, Njësia Administrative, Xiber, Bashkia Klos, Qarku Dibër

Fuqia e instaluar: 5.3 MW

(Bashkangjitur Anex 1 Harta dhe koordinatat)

Bazuar në pikën 2 të nenit 12 të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Drejtorive Teknike në Ministri:

Drejtoritë teknike të ministrisë shprehin mendimin si më poshtë vijon:

- Nuk janë mbajtur parasysh përcaktimet e VKM-së nr. 247, datë 30.04.2015 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore".

Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, *në rast se* zgjidhni pikën "a" apo "b" të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet:

Pas shyrimit të Raportit Teknik, skemës së vendosjes së veprave hidroteknike të HEC-eve në format DËG, si dhe koordinatave në sistemin Gauss-Kruger, rezulton se, Vepra e marrjes nr.1, e HEC "Guri i Bardhë 1", ndodhet 15 metër, brenda zonës së mbrojtur PM "Mali me Gropa - Bizë - Martanesh", shpallur me VKM-në nr.49, datë 31.01.2007, Peizazh i Mbrojtur "Mali me Gropa - Bizë Martanesh", kategoria e V e zonave të mbrojtura, sipas klasifikimit të IUCN-së.

Referuar planit të menaxhimit dhe zonimit të brendshëm të këtij peizazhi, sipërfaqja ku ndodhet vepra e marrjes nr. 1, ndodhet në zonën qendrore (ZQ), ku sipas ligjit nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura", neni 48, pika 3, shkronja d, citon se; "në nënzonën qendrore, janë të ndaluara ndërtimi i rrugëve, autostradave, hekurudhave, zonave urbane, hidrocentraleve, linjave të tensionit të lartë dhe sistemeve të naftës dhe gazit me shtrirje të lartë".

Përsa më sipër cituam, nuk lejohet ndërtimi i HEC-it nr.1, në këtë zone.

2. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:

1. Bazuar në Mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, gjukojmë se ky projekt, konkretisht HEC-i Nr. 1, shkakton ndikime të rëndësishme negative me pasoja afatgjata, që dëmtojnë cilësinë e mjedisit dhe nuk mundësojnë përmbushjen e standardeve mjedisore përkatëse.

2. Gjithashtu ju-risjellim në vëmendje se me anë të shkresës Nr. 880/1 Prot, datë: 25.06.2019, Prefekti i Qarkut Dibër, ka përcjellë pranë Drejtorisë rajonale të Mjedisit të Qarkut Dibër, një petition të banorëve të fshatrave Gur i Bardhë dhe Petralbë, Nj.A. Xibër, Bashkia Klos, Qarku Dibër, ku shprehet qartë shqetësimi dhe kundërshtimi i tyre për ndërtimin e HEC-eve në Gur të Bardhë. Ky petition është firmosur nga një numër i madh banorësh të zonës, shoqëruar edhe me Numra Identifikimi.

Gjatë shqyrtimit të Raportit të Thelluar të VNM, përveç të tjerave, një nga kriteret që merren parasysh është edhe procesi i konsultimit me publikun, si detyrim që vjen nga VKM nr. 686, datë: 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore” / Shtojca III, KRITERET NDIHMËSE PËR SHQYRTIMIN E RAPORTIT TË THELLUAR TË VNM-së DHE HARTIMIN E DEKLARATËS MJEDISORE, / Pika c) mënyrën sesi janë marrë në konsideratë, në raportin e thelluar të VNM-së, mendimet dhe sugjerimet e dhëna nga palët e përfshira gjatë procedurës së VNM-së, sidomos ato të konsultimit e dëgjësës publike

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM


EDISON KONOMI

MINISTRI


BLENDI KLOSI



1. Anex 1. Harta dhe koordinat

